



| | | | | |
|---|------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|----------------------|
| Pranimi / Dorezimi Prilazimi / Prilazje K. nr. / K. No. | | 17.10.2022 | 2 | viti god. year |
| Organ / Njësia Org / Unit | Dr. Prot. Dr. Prot. Prot No. | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity | |
| SKPM/STPA/6270/2022 | | | 114 | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.801/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.801/2022 të datës 15.09.2022 të parashtruar nga ankuesja nga Komuna e Klinës, me adresë kundër organit të punësimit Komunes së Klinës, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e papabuar ankesa me numër A.nr.801/2022 e datës 15.09.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Klinës, më datë 15.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5426/2022 në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes së Zyrës Personale të Komunes së Klinës, për shkak të moszbatimit të Vendimit me numër 02Nr.120-1047/2015 të datës 02.02.2015 dhe mos realizimi të pagës konform këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 19.09.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses të Komuna e Klinës, ndërsa kjo e fundit më datë 22.09.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të shqyrtimit dhe vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5426/2022 të datës 15.09.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e ankueses përmes emailit e datës

07.09.2022 për Përgjigjen e datës 07.09.2022 përmes emailit nga për ankuesen; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit me numër 02Nr.112-27336/19 të datës 27.06.2019 për ankuesen; Certifikatën e martesës me Nr. Serik M 10309695; Listën e pagave për muajin gusht 2020 për ankuesen; Vendimin me numër 02 Nr.120-1047/2015 të datës 02.02.2015 të Drejtorit të Administratës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 19.09.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 22.09.2022; Akt Emërimit me numër 02Nr. 112-2934/11 i datës 01.08.2011; Vendimin me numër 01-Nr.20-4741/2018 të datës 04.07.2018 të Kryetarit të Komunës për anulimin e vendimit të datës 08.05.2012 për rritjen e koeficienteve të administratës së Komunës së Klinës; Akt Përcjellës për Departamenti e Administrimit të Shërbimit Civil nga Kryetari i Komunës së Klinës i datës 03.03.2015.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankueses, *është e pabazuar, sepse:*

Nga administrimit i provave materiale rezulton se ankuesja është e punësuar në Komunën e Klinës, gjegjësisht e njëjta sipas Akt-it të Emërimit me numër 02Nr.112-2934/11 të datës 01.08.2011 është emëruar në pozitën *Zyrtare e Pranimit të Mallrave* në Drejtorinë për Ekonomi e Zhvillim me koeficient pesë (5), ndërsa më datë 27.06.2019 i është lëshuar ndryshimi dhe plotësimi i Aktit të Emërimit me numër 02 Nr.112027336/19 për shkak të ndërrimit të mbiemrit nga

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton së më Vendimin me numër 02Nr.120-1047/2015 të datës 02.02.2015 të Drejtorit të Administratës së Komunës së Klinës ankueses i është korrigjuar koeficienti i pagës nga pesë (5) në gjashtë (6) duke përcaktuar që ankuesja të jetë profesional.

Po nga shqyrtimi shkresave të lëndës Kolegji ka konstatuar së ankuesja më datë 07.09.2022 ka parashtruar kërkesë të Udhëheqësi i Personalit për ekzekutimin e Vendimit me numër 02Nr.120-1047/2015 të datës 02.02.2015 të Drejtorit të Administratës së Komunës së Klinës.

Udhëheqësi i Personalit i Komunës së Klinës në përgjigje të kërkesës së ankueses të datës 07.09.2022 ka udhëzuar ankuesen që për këtë çështje t'i drejtohet gjykatës kompetente.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së me Vendimin me numër 02 Nr.120-1047/2015 të datës 02.02.2015 të Drejtorit të Administratës së Komunës së Klinës i është ngritur koeficienti i pagës nga pesë (5) në gjashtë (6), mirëpo ky vendim nuk është zbatuar nga komuna. Propozon që Këshilli të aprovoj si të bazuar ankesën e ankueses dhe të obligoj Komunën e Klinës që të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e Akt-it të Emërimit sipas nenit 3 të vendimit të datës 02.02.2015 si dhe të bëjë kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga data 02.02.2015 deri në zbatim të këtij vendimi.

Në pikëpamje të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht:

Nenin 51 ku përcaktohet se: *Një akt administrativ fillon të prodhojë pasojat juridike në raport me palën të cilës i drejtohet apo e cila cenohet nga ai, me njoftimin e përmbajtjes të tij...4. Një akt administrativ do të prodhojë pasoja juridike për aq kohë sa nuk është anuluar apo shfuqizuar sipas detyrës zyrtare apo si rezultat i ushtrimit të njeteve juridike administrative apo gjyqësore, nuk skadon për arsye të kohës apo përmbushjes së qëllimit të tij, apo nuk pushon së prodhuari të pasojave, për çfarëdo arsye tjetër të paraparë me ligj.*

Nenin 144 ku përcakton se: " 1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar;1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa, 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullue.1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës.2. Akti i zgjidhjes së ankesës që ndryshon një akt administrativ të ankimuar, bëhet i ekzekutueshëm me njoftimin e palës. 3. Akti administrativ nuk mund të ekzekutohet nëse kanë kaluar pesë (5) vite nga koha kur akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim ekzekutimi, apo kanë kaluar 3 (tre) vite nga veprimi i fundit për ekzekutimin.

Andaj, referuar kuadrit ligjor të përshkruar si me lartë dhe meqenëse nga administrimi i shkresave të lëndës nuk rezulton të jetë ndërmarr ndonjë veprim ligjor për ekzekutim apo kundërshtim të Vendimit numër 02 Nr.120-1047/2015 të datës 02.02.2015 të Drejtorit të Administratës së Komunës së Klinës nga organi punëdhënës, Kolegji i Këshillit konstaton se ekzekutimi i Vendimit në fjalë në kuptim të njohjes së të drejtës së ankueses lidhur me ngritje të koeficientit të pagës është i pamundur ligjërisht, pasi që, kanë kaluar mbi pesë (5) vite nga koha e nxjerrjes së kiji vendimit, kështu që nisur nga ky konstatim, Kolegji nuk është lëshuar në vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit numër 02 Nr.120-1047/2015 të datës 02.02.2015 të Drejtorit të Administratës së Komunës së Klinës.

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejt lidhur me këtë çështje juridike-administrative, po ashtu ka analizuar edhe Katalogun e Vendeve të punës për shërbyesit civilë i miratuar me datë 05.02.2015 dhe i ndryshuar dhe plotësuar me datë 21.02.2018, nga ka konstatuar se pozita "Zyrtar i Pranimit të Mallrave", nuk është paraparë si e tilla më këto dokumente ligjore, mirëpo përshkrimi i detyrave të pranimit të mallit janë përcaktuar si detyra të Zyrtarit të Depos me kod AD/220, dhe se për këtë pozitë punë është përcaktuar grada 12 e pagës.

Rrjedhimisht, në funksion të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore Kolegji ju referua Nenin 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: "Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave", ndërsa ndërlidhur me këtë Neni 9 paragrafi 1 i Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësive Civil, përcakton se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kontratës së punës". Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji i Këshillit konstaton se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës, kështu që mbi këtë bazë ligjore dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesja realizon koeficientin e pagës të përcaktuar sipas Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit me numër 02Nr.112-27336/19 të datës 27.06.2019 dhe meqenëse në provat e kësaj çështje nuk ka ndonjë akt tjetër administrativ lidhur me ngritje/harmonizim të koeficientit të ankueses, Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankueses për ngritje të koeficientit të pagës pesë (5) në gjashtë (6) mbi bazën e Vendimit numër 02 Nr.120-1047/2015 të datës 02.02.201, janë të pabazuara.

Kështu që duke u bazuar në dispozitat ligjore të sipër cekura dhe duke qenë se ankuesja realizon pagën sipas koeficientit të përcaktuar me Akt emërim, Kolegji i Këshillit konstaton se në këtë çështje administrative nuk ka gjetur rrethanat të trajtimit jo të barabartë dhe diskriminues të ankuesit ashtu siç edhe është përcaktuar me Ligjin Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 ku thuhet se: *Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë*



më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji...”

Theksuar si me lart, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.801/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Klinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së